



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agjencia Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 552/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të BPrAL Kolegji “UBT” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
 - Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment, BSc, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik (me specializime: Burimet e Energjisë; Konzervimi i Energjisë; Eficenca e Energjisë; Menaxhimi i Energjisë; Inxhinieri Elektrike; Konzervimi i Energjisë në Ndërtesa; Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes; Energjia Gjeotermike);
 - Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment, Niveli V, 120 ESTC, maksimumi 50 studentë për vit akademik (me specializime: Burimet e Energjisë; Konzervimi i Energjisë; Eficenca e Energjisë; Menaxhimi i Energjisë; Inxhinieri Elektrike; Konzervimi i Energjisë në Ndërtesa; Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes; Energjia Gjeotermike).
- II. Nuk akreditohen programet e studimit të BPrAL Kolegji “UBT”:
 - Inxhinieri e Qëndrueshme dhe Menaxhment, MSc, 60 ECTS (me specializime: Energji; Ushqim; Uji; Mjedis; Transport; Planifikim dhe të dhëna Infrastrukturore);
 - Psikologji dhe Menaxhim, BSc, 180 ECTS (me specializime: Psikologjia e Punës dhe Industriale; Psikologjia Klinike; Psikologjia e Fëmijëve; Psikologjia Sociale dhe Edukimi).
- III. Obligohet BPrAL Kolegji “UBT” që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- IV. Obligohet BPrAL Kolegji “UBT” që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji "UBT" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimit: Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment, BSc, 180 ECTS, Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment, Niveli V, 120 ESTC, Inxhinieri e Qëndrueshme dhe Menaxhment, MSc, 60 ECTS, Psikologji dhe Menaxhim, BSc, 180 ECTS me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment	BSc	180	Besa Veseli, Sami Makolli, dhe Sami Gashi
2	Inxhinieri e Energjisë dhe Menaxhment	Niveli V	120	Ines Bula, Ramiz Hoxha, dhe Valmir Hoxha
3	Inxhinieri e Qëndrueshme dhe Menaxhment	MSc	60	Hyzer Rizani, Nexhat Balaj, dhe Suzana Aliu
4	Psikologji dhe Menaxhim	BSc	180	Besnik Elshani, Metush Sylejmani dhe Agim Pireva

AKA ka organizuar dy vizita të ndara në Kolegjin "UBT". Vizita e parë është realizuar me 19.05.2017, ndërsa vizita e dytë me 31.05.2017 me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Balint Bachman, Robert Masten, Patricia Kotnik, Laszlo Fulop dhe Gabor Dombay.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit "UBT", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me programin e studimit Inxhinieri e Qëndrueshme dhe Menaxhment, MSc, 60 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve, Raporti i Vet Vlerësimit përmban një numër të mangësive dhe gabimeve, teknike dhe gramatikore, mirëpo edhe informata të cilat mungojnë. Sipas ekspertëve dy nën kapituj janë 100% të njëjtë me dy programe të tjera të studimit dhe sipas ekspertëve këto mangësi janë të paarsyeshme dhe se nuk duhet të jenë pjesë e një dokumenti kaq të rëndësishëm.

Për sa i përket përmbajtjes së programit të studimit, ekspertët kanë deklaruar se propozimi për një program 1 vjeçar me 60 ECTS nuk ofron njohuri të thella dhe të mjaftueshme shkencore dhe specifike dhe as ECTS të mjaftueshme për një nivel Master të studimit. Sipas ekspertëve edhe pse struktura e kurrikulës është

përgjithësisht e mirë duket se ka mangësi për sa i përket njohurive më të detajuara dhe shkencore e cila është e nevojshme për një nivel master në inxhinieri.

Për sa i përket stafit akademik ekspertët kanë deklaruar se tre bartësit e programit të studimit janë shkencëtarë të respektueshëm në fushat e tyre të studimit, përkatësisht në mikrobiologji, hortikulturë dhe kimi, megjithatë asnjëri nga ta nuk është specialist në inxhinierinë e energjisë. Edhe pse programi i propozuar Master është program ndërdisiplinor mund të jetë e pranueshme që në të të përfshihen ekspertë nga fusha e ambientit me kushtin që njëri nga ta, të paktën bartësi kryesor i programit, të jetë specialist apo të ketë referenca në inxhinierinë e energjisë. Sipas ekspertëve, ky kriter minimal për momentin nuk është përmbushur.

Në lidhje me programin e studimit Psikologji dhe Menaxhim, BSc, 180 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve, raporti i vet vlerësimit i Kolegjit UBT është mjaft i paqartë, me shumë gabime dhe informata të mangëta, posaçërisht për sa i përket listës së stafit akademik.

Për sa i përket përmbajtjes së programit të studimit ekspertët kanë gjetur informacione jokonsistente për sa i përket numrit të ECTS-ve kur janë bërë krahasimet mes tabelave dhe syllabuseve. Disa lëndë nuk i kanë titujt e njëjtë sikurse tabelat dhe syllabuset. Gjitha lëndët e studimit sipas ekspertëve kanë literaturë bazike e cila në shumicën e rasteve është e vjetërsuar dhe është në gjuhën angleze, çka është problematike meqenëse shumica e studentëve nuk kuptojnë gjuhën angleze mjaftueshëm. Po ashtu ekspertët kanë deklaruar se syllabuset për profilet e semestrit të 5-të dhe 6-të nuk janë ofruar fare.

Për sa i përket stafit akademik ekspertët kanë deklaruar se struktura e kualifikimit të stafit akademik është dukshëm e papërshtatshme. Për më tepër lista e stafit akademik në listën e AKA-së është e ndryshme prej listës së stafit të paraqitur në Raportin e Vet Vlerësimit. Përtej gabimeve teknike dhe paqartësive të stafit akademik, ekspertët kanë deklaruar se megjithatë problemet në lidhje me stafin akademik nuk janë vetëm të natyrës teknike mirëpo problemi ekziston në numrin e vogël të stafit akademik me kualifikim PhD të cilët janë psikolog për nga përgatitja universitare dhe se edukimi mjekësor posaçërisht specializimet në neuroshkenca nuk është kompatibil me fushën shkencore të psikologjisë klinike. Po ashtu sipas ekspertëve specializimi në fushën mjekësore të psikiatrisë nuk është i përshtatshëm për lëndët psikologjike.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "UBT";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Assoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë